



Datë: 02.03.2026

Numër Protokolli: 1087/2026

A.nr.213/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.213/2026, të datës 25.02.2026, të parashtruar nga ankuesja F.Z.B, kundër organit të punësimit/Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.03.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.213/2026, e datës 24.02.2026, e parashtruar nga ankuesja F.Z.B.

A r s y e t i m

Ankuesja F.Z.B (tutje referuar ankuesja), më datë 24.02.2026, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.213/2026, kundër Njoftimit të datës 20.02.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00019194, për pozitën e punës *Zyrtar Administrativ*, të shpallur nga Komuna e Gjakovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Komuna e Gjakovës me datë 08.01.2026, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00019194, për pozitën e punës “*Zyrtar Administrativ*”, me afat të aplikimit nga data 09.01.2026-07.02.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo, më Njoftimin e datës 20.02.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, i është refuzuar aplikacioni për arsyetimin: “...Dëshmitë e përvojës së punës janë të pamjaftueshme ngase në konkurs është kërkuar së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës dhe të njëjtat duhej të mbështeteshin me dëshmitë si në vijim: vërtetim/konktratë të lëshuar nga institucioni përkatës i

punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë ...”

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton ligjshmërinë e Njoftimit të datës 20.02.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, për refuzimin e aplikacionit, me pretendimet së ka bashkëngjitur dëshmi për përvojën e punës në ndërmarrje të ndryshme. Kërkon që vendimi të rishqyrtohet dhe të mundësohet vazhdimi në fazat tjera të rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 25.02.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidatja për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 25.02.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Ref: RN00019194, rrjedhë se ankesa e ankueses A.nr.213/2026, e datës 25.02.2026, është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.213/2026 nuk mohon të drejtën e ankueses që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.213/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.Z.B;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.